

Përshëndetje,

Kam kënaqësinë të ju uroj mirëseardhje në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, me rastin e ndarjes së çmimeve për esetë më të mira në kuadër të garës:

- **"Planifikoni paratë tuaja, mbillni të ardhmen tuaj"**, mesazhi i të cilës është që të fokusohemi në qëndrueshmërinë dhe ngritjen e ndërgjegjësimit mbi implikimet e sjelljes individuale financiare, jo vetëm për të ardhmen financiare, por edhe për mjedisin dhe shoqërinë.
- BQK, nga viti 2013 është pjesë e këtij organizimi, i cili udhëhiqet nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), e që ka për qëllim ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe të rinjve rreth çështjeve ekonomike e financiare.
- Java Ndërkombëtare e Parasë organizohet në 176 vende të botës dhe në këtë ngjarje pothuajse çdo vit marrin pjesë rreth 53 milionë fëmijë e të rinj nga shtete të ndryshme të botës.
- Banka Qendrore është e angazhuar në nxitjen dhe ruajtjen e stabilitetit financiar në vend, dhe gjithashtu ka për detyrë të rregullojë dhe mbikëqyrë, sistemin financiar në Kosovë dhe të sigurojë që ai të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive. Sot sektori financiar është një ndër kontribuuesit kryesorë në ekonominë e Kosovës dhe është një prej sektorëve më stabil e më të suksesshëm në Kosovë, si dhe një nga shtyllat kryesore të mbështetjes për bizneset dhe individët. BQK-ja mbetet e përkushtuar që të vazhdojë aktivitetin e saj në shërbim të stabilitetit dhe zhvillimit të ekonomisë së vendit, duke krijuar kushtet për zhvillimin e një infrastrukture të qëndrueshme financiare, në linjë me zhvillimet bashkëkohore në këtë fushë.
- Edukimi financiar është një funksion përmes të cilës BQK kontribuon në informimin dhe ngritjen e njohurive të qytetarëve me qëllim të përmirësimit të

njohurive të tyre rreth koncepteve ekonomike e financiare, produkteve, shërbimeve që i ofron sektori financiar dhe krijimit të shprehive për të bërë zgjedhje të duhura dhe ndërmarrë veprime efektive për të përmirësuar mirëqenien e tyre financiare.

- Edukimi Financiar është i rëndësishëm për BQK-në sepse kontribuon në stabilitetin e sistemit financiar: Qytetarët e informuar e të edukuar financiarisht, njohin më shumë dhe kuptojnë produktet dhe shërbimet e sektorit financiar, janë më të mbrojtur, si dhe janë më të aftë për të marrë vendime të zgjuara dhe të menaxhojnë më mirë financat e tyre, gjithashtu edhe për të përballuar situata të vështira financiare. Kjo ndihmon në zvogëlimin e rrezikut të krizave financiare dhe në ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar.
- Me anë të konkursit për Esenë më të mirë, qëllimi parësor është që të nxitim të rinjtë e shkollave të mesme që të jenë më të informuar rreth temave ekonomike e financiare.
- BQK do të vazhdojë të jetë e fokusuar që në vazhdimësi me qëllim të avancojë fushën e edukimit financiar, me qëllim që të kontribuojmë në ngritjen e njohurive, transparencës dhe informimit të qytetarëve dhe në veçanti konsumatorëve të produkteve, si dhe shërbimeve financiare. Gjithashtu, do të vazhdojmë të bashkëpunojmë me institucione vendore e ndërkombëtare financiare me qëllim që përmes këtij funksioni, të jemi sa më afër qytetarëve.

Për fund, dua t'ju falënderoj për praninë e Juaj në ndarjen e këtyre çmimeve dhe me këtë rast Ju po jeni më afër Bankës Qendrore dhe do të keni njohjen më të madhe me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, e po ashtu edhe me funksionimin e sektorit financiar në Kosovë dhe këto njohuri të fituara që t'i plotësoni pse jo me studimet tuaja në drejtimet financiare në universitetet në vend apo jashtë dhe në një të ardhme Ju të jeni bartës të zhvillimit dhe drejtimit të financave të vendit tonë, qoftë në Bankë Qendrore apo në institucionet tjera financiare.

Urime për çmimet dhe suksese në mësimet e në sfidat e reja shkollore, gjithë të mirat!